



**Federata e Peshkatarëve Sportiv Recreativ e Kosovës**  
**Savez Sportsko Recreativnih Ribolovaca Kosova**  
**Kosovo Federation of Sports Recreational Fishermen**

**Draft**

**RREGULLORE NR. 8 / 2024 PER ANTIDOPING**

Në bazë të 63 të Ligjit të Sportit të Kosovës nr. 2003/24 dhe nenit 19 të Statutit të Federatës së Peshkatarëve Sportiv Recreativ të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më Bordin e FPSRK-së propozon rregulloren:

### **Neni 1**

Me rregulloren e masave për preventivë dhe parandalim të përdorimit të dopingut (Tutje referuar si “**Rregullorja**”) përcaktohen masat dhe aktivitetet për parandalimin e përdorimit të dopingut, si dhe procedurat e masave disiplinore në rastet e përcaktuara të përdorimit të dopingut tek sportistët.

### **Neni 2**

1. Dopingut është i ndaluar.
2. Dopingut është një ose më shumë shkelje e rregullave të anti dopingut.
3. Shkelja e rregullave Anti- doping ekziston në rastet e përcaktuara në nenin 81 të ligjit të sportit.
4. Federata e Peshkatarëve Sportiv Recreativ të Kosovës është e detyruar të sigurojë, brenda kompetencave të saj që për lojtarët, trajnerët dhe personat tjerë, për të cilët është përcaktuar (krijuar, vërtetuar) përgjegjësi për doping, që të merren masat e duhura, në paktin me Ligjin për parandalimin e dopingut në sport dhe rregulloren e Organizatës përkatëse të Anti-Dopingut dhe rregullat e Agjencisë Botërore Anti – Doping dhe kësaj rregullorje.

### **Neni 3**

1. Të gjitha lojtarët dhe pjesëmarrësit e tjerë në kryerjen e veprimeve dhe aktiviteteve sportive brenda FPSRK-së janë të obliguar të lejojnë dhe mundësojnë kryerjen e kontrollit të dopingut.
2. Lojtarët të cilët refuzojnë, nuk marrin pjesë, shmangen ose pamundësojnë kontrollin e dopingut, do t’ju shqiptohen masa për shkelje të rregullave Anti-Doping sikur të ishin pozitiv në testin e dopingut, dhe në rast të përpjekjes së tillë, atij mund ti përcaktohet masa edhe nëse testi i dopingut është negativ.

#### **Neni 4**

1. Garuesi është i detyruar të informoj mjekun i cili është duke e trajtuar atë në lidhje me detyrimin e tij për të mos përdorur substanca dopingut dhe për tu siguruar se çdo terapi mjekësore e përdorur nuk përmban substanca dopingut. Nëse terapia e përdorur përmban substanca të dopingut, atleti është i obliguar që ti drejtohet Komisionit Shëndetësor të FPSRK-së me kërkesë për miratimin e përjashtimeve për përdorim terapeutik.
2. Në këtë drejtim FPSRK-së do të njoftoj lojtarët me të drejtën dhe detyrimin për të kërkuar nga Komisioni Anti-Doping, që t'ju liroj ndalesën e përdorimit të substancave të dopingut, në rastin kur ekziston një nevojë e qartë dhe e domosdoshme mjekësore.

#### **Neni 5**

1. Kontrolli dopingut në Kosovës kryhet sipas rregullave të përcaktuara nga Komisioni Anti-Doping, kurse në rastet kur kontrolli i dopingut bëhet në garat ndërkombëtare nën menaxhimin e FIPS dhe sipas rregullat e saj.
2. Kontrolli i dopingut mund të organizohet në garën ose jashtë garës, me paralajmërim dhe pa paralajmërim, dhe kryhet me marrjen e mostrave të urinës dhe të gjakut, ose duke aplikuar teknika të tjera të autorizuara për zbulimin e substancave dhe metodave të ndaluara, ekskluzivisht nga kontrollorët e autorizuara dhe të kualifikuar, ose nga personat që posedojnë leje të lëshuar nga Komisioni Anti-Doping, ose nga Komisioni i njohur ekuivalent.

#### **Neni 6**

Statutit të Federatës së Peshkatarëve Sportivë Recreativë të Kosovës do të përcaktojnë me një vendim të veçantë personin përgjegjës për monitorimin e zbatimit të masave për parandalimin e dopingut në Kosovë.

#### **Neni 7**

1. Kur në procesin e kontrollit të dopingut krijohet një shkelje e rregullave Anti-Doping, personi përgjegjës për monitorimin e zbatimit të masave për parandalimin e dopingut brenda FIPS do të takoj lojtarin me të drejtë që pa vonesë, dhe jo më vonë se 7 ditë, të kërkojë avokatin në praninë e tij në hapjen dhe analizimin e mostrës "B", me shpenzimet e veta, me të drejtë të kërkojë kopjen e dokumentacionit laboratorik të mostrës "A dhe B" e cila përmban informacionin e kërkuar nga Standarti Ndërkombëtar për analiza laboratorike dhe të drejtë që të jetë në formë të shkruar komentimin mbi rrethanat e rastit aktual (konkret) Komisioni Anti-Doping, brenda 7

ditëve. Nëse garuesi nuk e kërkon analizën e mostrës “B” brenda 7 ditëve do të konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta e tij për analizën e mostrës “B”.

2. Nëse me analizën e mostrës “B” vërtetohet analiza e gjetjes së dëshmive e cila largohet prej asaj sa është e lejuar ose nëse Peshkatari shprehimisht apo në mënyrë të heshtur të heqë dorë nga e drejta e analizës së mostrës “B” do të fillojë procesi i marrjes së masave për personat përgjegjës për doping.

### **Neni 8**

1. Rreth vendosjes së masave të akuzuarit që përballet me shkeljen e rregullave të anti-dopingut vendos në shall të parë Komisioni Disiplinor i Federatës.
2. Komisioni disiplinor i përmendur në paragrafin e 1 të këtij neni do të vendos me shumicë votash (ose ndryshe nëse parashikohet ndryshe nga një akt tjetër i Shoqatës Kombëtare të Sportistëve ).
3. Komisioni Disiplinor do të siguroj që të respekton personalitetin dhe të drejtën e mbrojtjes adekuate ligjore të personit përgjegjës për doping (respektimi i privatësisë, kërkimi (hulumtimi) me kohë, garantimi i të drejtës për një shpjegim ligjorë, gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtën për një përfaqësues ligjor në shpenzimet personale, lejimi i shikimit të dokumenteve, dosjet e dëshmive. Pajtueshmëria me standartet në aspektin e dëshmisë së dopingut, informimi me kohë, vendimi dhe me arsyetimit me shkrim me kohë, të drejtën e ankimit, etj.).
4. Ligjshmërinë dhe rregullsinë e procedurës e merr parasysh personi përgjegjës për monitorimin e zbatimit të masave për parandalimin e dopingut në Kosovë.

### **Neni 9**

1. Masat e shqiptuar për shkeljet të rregullave anti doping janë:
  - 1) Diskualifikim i rezultateve sportive të skuadrës,
  - 2) Suspendimi i përkohshëm
  - 3) Ndalimi për të marr pjesë në garë
  - 4) Ndalimi për të kryer funksione në fushën e sportit.

në periudhën kohore, sipas kushteve dhe në përputhje me ligjin e sportit.

### **Neni 10**

Vendimi i komisionit disiplinor do t'i dorëzohet FIPS dhe FPSRK-së dhe komisionit Anti Doping të Federatës.

### **Neni 11**

Nëse Federata nuk vendosë masa për shkeljen e rregullave anti-doping brenda viti prej kur me analizën e mostrave të marra është treguar se garuesi është stimuluar dopinguar)

në shkelje të rregullave anti-doping vendos në shkallë të parë dhe par afatit të referuar në paragrafin 1 të këtij neni.

#### **Neni 12**

Në vendimin e komisionit disiplinor mund të bëhet ankesë në Komisionin e shkallës së dy Këshillin e garave për afat dhe për kushtet e parashikuar nga rregullorja mbi përcaktimin e përgjegjësive të personit që ka kryer shkeljen e rregullave anti-doping, përveç ku në përputhjen me ligjin nuk është përcaktuar, d.th.th nga juridiksioni e FIPS për të vendosur në lidhje me ankesën.

#### **Neni 13**

Nëse në shkeljen e rregulloreve anti -doping vendos Komisioni Anti Doping i Federatës, ka të drejtë të caktoj një ekspert i cili do të ndihmoj garuesi në procesin dhe t'ju japë këshilla kur është e nevojshme.

#### **Neni 14**

Statutit të Federata e Peshkatarëve Sportiv Rekreativ e Kosovës është e obliguar që të rregullojë procedurën për njohjen e ndërsjellët të suspendimi dhe masave të tjera të vendosura nga shoqatat e tjera sportive në vend dhe jashtë vendit dhe për të siguruar që federata i përmbahet masave të shqiptuara dhe suspenduara.

#### **Neni 17**

Statutit të Federata e Peshkatarëve Sportiv Rekreativ e Kosovës do të miratojë një program të veprimit Anti- Doping

#### **Neni 18**

Statutit të Federata e Peshkatarëve Sportiv Rekreativ e Kosovës është e obliguar për të siguruar përcjelljen e vazhdueshme individuale mjekësore të sportistëve elitar, dhe për këtë qëllim do të nxjerrë aktet e nevojshme dhe për të marr masa konkrete.

#### **Neni 19**

Statutit të Federata e Peshkatarëve Sportiv Rekreativ e Kosovës të paktën një herë në vit do të informoj dhe edukoj anëtarët e saj dhe peshkatarë me rregullore aktuale në lidhje me dopingun në sport dhe efektet e dëmshme për shëndetin, kur përdoren substancat e dopingut.

### **Neni 20**

Të gjithë anëtarët e FPSRK-së janë të detyruar të respektojnë detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i masave për të luftuar dopingun në sport.

### **Neni 21**

Statutit të Federatës së Peshkatarëve Sportivë Recreativë të Kosovës është e obliguar të shkurtoj pjesërisht ose plotësisht financimin e garuesve, organizatave sportive dhe subjekteve tjera që nuk përputhen me rregullat ekzistuese anti – doping, si dhe nuk kontrollojnë programet Anti – Doping të anëtarëve të saj dhe zbatimin e këtyre programeve.

### **Neni 22**

Statutit të Federatës së Peshkatarëve Sportivë Recreativë të Kosovës do të informojë Ministrinë përgjegjëse për sport dhe Agjencionin Kombëtar të Anit - Dopingut mbi masat për të luftuar dopingun të ndërmarr gjatë vitit.

### **Neni 23**

Statutit të Federatës së Peshkatarëve Sportivë Recreativë të Kosovës në bashkëpunim me Agjencionin Kombëtar të Anti dopingut mund ti propozoj për kryer testime në kontrollimin e në garat e caktuar apo kontrolli jashtë garës së ekipeve të caktuara, grupeve të treningut apo peshkatarëve individual.

### **Neni 24**

Statutit të Federatës së Peshkatarëve Sportivë Recreativë të Kosovës do të njoftoj garuesit - anëtarët e grupit kombëtar të regjistruar të testime, me obligim që Agjencisë Anti-Doping të Kosovës ka marrë për monitorimin masave për parandalimin e dopingun, rregullisht dhe me saktësi ti informojnë në lidhje me ve ndodhjen dhe qasjen, në rregulloret e dopingut në garat sportive dhe jashtë garës.

## Neni 25

Statutit të Federata e Peshkatarëve Sportiv Rekreativ e Kosovës rregullisht do të informoj anëtarët e saj dhe atlet për listat e referimit të substancave të ndaluara.

## Neni 26

Kjo rregullore, si dhe çdo ndryshim i saj eventual i mëvonshëm do të dorëzohet në Ministri e Sportit dhe Komisionin Kombëtar të Antidopingut brenda 15 dite nga dita e hyrjes në fuqi

## Neni 27

Kjo Rregullore hyn në fuqi, shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Kryetari i **Federata e Peshkatarëve Sportiv Rekreativ e Kosovës** dhe publikimit në faqen zyrtare të FPSRK-së.

Milaim Viti



Kryetar i Federata e Peshkatarëve Sportiv Rekreativ e Kosovës